

Prot. n. 2330770/21  
29/07/2021

Kodi i pyetësorit: CAMPO\_1

E nderuar Zonjë, I nderuar Zotëri,

duke filluar nga muaji tetor zhvillohet Censusi i përhershëm i popullsisë dhe i banesave, realizuar nga Istat - Instituti Kombëtar i Statistikës.

Nga viti 2018 Censusi organizohet ndryshe nga e kaluara: çdo vit marrin pjesë grupe qytetarësh të caktuar me kriter rastësor midis familjeve rezidente në Komunitat që bëjnë pjesë në kampion. Emri juaj është nxjerrë nga lista e gjendjes civile të familjeve rezidente në Komunë deri në datën 01/01/2021.

Rilevimi, që përfshin familjen tuaj, do të bëhet nga **4 tetor** deri **23 dhjetor 2021**.

Të dhënat e kërkuara do të shërbejnë për të njohur karakteristikat kryesore sociale e demografike të popullsisë të vendit tonë, numrin e banesave dhe karakteristikat e atyre që banohen efektivisht.

Istat e bën këtë rilevim dhe trajtimin përkatës të të dhënave personale duke kryer një detyrë me interes publik. Rilevimi i Censurit parashikohet në fakt nga Rregullorja europiane n. 763/2008, nga ligji n. 205/2017, dhe hyn në Programin statistikor kombëtar në fuqi (IST-02494), që parashikon, për këtë rilevim, detyrim e mundësi sanksionimi.

Informacionet e mbledhura do të trajtohen duke respektuar normativën në lëmin e tutelës së sekretit statistikor e të mbrojtjes së të dhënave personale (shikoni seksionin "Trajtimi i të dhënave" në pjesën e pasme të letrës).

Për mbarëvajtjen e rilevimit dhe mbi të gjitha për t'i pasuruar të dhënat statistikore të dobishme për kolektivitetin, do të jetë thelbësor bashkëpunimi i plotë i familjes suaj.

Ju falënderoj për kontributin që do të jepni.

Firmosur nga Gian Carlo Blangiardo

## UDHËZIME PËR T'JU PËRGJIGJUR PYETËSORIT

Nga **4 TETOR** deri **7 NËNTOR** familja mund ta përpilojë online pyetësorin duke përdorur një nga mënyrat e mëposhtme:

- Duke shkuar në adresën <https://raccoltadati.istat.it/questionario> e duke futur të dhënat e hyrjes në anë ose, në rastin e titullarit, duke përdorur SPID-in e vet ose CIE.
- Duke shkuar pranë Qendrave Komunale të Rilevimit (CCR), në punë për të gjithë periudhën e rilevimit, ku mund të përdorë një kompjuter me internet për ta përpiluar pyetësorin në mënyrë autonome ose nëpërmjet intervistës së drejtuar nga një operator komunal, të kërkojë informacione e sqarime.



### TË DHËNAT E HYRJES

**KODI I PËRDORUESIT:** Kodi fiskal i titullarit

**PIN:** CAMPO\_2

Nga **8 NËNTOR** deri **23 DHJETOR** familjet që nuk e kanë përpiluar ende pyetësorin online, do të kontaktohen nga një operator komunal për një intervistë telefonike ose ballë për ballë.

Deri më **13 DHJETOR** familja mund të vazhdojë ta përpilojë pyetësorin online duke përdorur të dhënat e hyrjes. Nga data **14 DHJETOR** intervista do të mundësohet vetëm nëpërmjet operatorit komunal, pranë banesës së vet ose pranë Qendrave Komunale të Rilevimit. Nëse takimi për intervistën është caktuar prej kohësh pranë banesës së vet, pyetësori duhet të përpilohet vetëm me ndihmën e rilevuesit komunal.

## UDHËZIME E NDIHMË

- Kontaktoni **Numrin e Gjellbër Istat 800.188.802**, aktiv çdo ditë nga 1 tetor deri 23 dhjetor, nga ora 9.00 në orën 21.00
- Shkruani në adresën e postës elektronike [censimentipermanenti.popolazionee-abitazioni@istat.it](mailto:censimentipermanenti.popolazionee-abitazioni@istat.it)
- Konsultoni faqen internet të Istat në adresën <https://www.istat.it/it/censimenti-permanenti/popolazione-e-abitazioni>

